



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 660/1 prot.

Tiranë, më 25 01. 2024

Lënda: Kualifikimi i mësuesve për vitin shkollor 2023-2024

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

LEZHË

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL
DHE KUALIFIKIMEVE**

Rruga "Mustafa Lleshi", Godina e Thesarit,
Tiranë

**Për dijeni: AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**
Rruga "Naim Frashëri" Nr. 37,
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga "Aleksandër Moisiu",
Tiranë

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 2, datë 08.02.2023, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), zhvillojnë procedurat për organizimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar të vënë në shërbim të mësuesve programet e kualifikimit, brenda datës 20 shkurt 2024. Programet mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

2. Mësuesi që kërkon të kualifikohet, plotëson kërkesën për të marrë pjesë në procedurat e kualifikimit dhe e dorëzon atë në ZVAP së bashku me portofolin profesional sipas profilit përkatës, brenda datës 27 shkurt 2024.
3. ZVAP-ja harton listat e kandidatëve për provimet e kualifikimit, së bashku me vlerësimet e portofolit (sipas formatit të ASCAP-it), brenda datës 15 mars 2024.
4. Lista e mësuesve që do të marrin pjesë në provimet e kualifikimit t'u bëhet e ditur mësuesve deri më datë 18 mars 2024, në mënyrë që secili mësues të kontrollojë të dhënat dhe vlerësimet e portofolit të tij. ZVAP-ja dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në DRAP listat e mësuesve që do të marrin pjesë në kualifikim, brenda datës 22 mars 2024.
5. DRAP-ja harton listat përfundimtare për të gjitha ZVAP-të nën juridiksion të saj, sipas formatit të ASCAP-it, dhe i dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në ASCAP dhe në DPAP, brenda datës 25 mars 2024. Pas kësaj date nuk bëhen ndryshime në listën e mësuesve për kualifikim.
6. ASCAP-i, në bashkëpunim me DPAP-në, organizon dhe administron procesin e provimeve të kualifikimit për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë, harton listën e përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve të provimit të kualifikimit sipas mjediseve dhe numrit të përcaktuar prej tij.
7. Provimi me shkrim për mësuesit e kategorisë II dhe III të kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024 do të zhvillohet më datë 11.05.2024, ora 10 deri 12:30, në Tiranë, në mjedise të planifikuara nga ASCAP-i.
8. ZVAP-ja, në bashkëpunim me drejtuesit e rrjeteve profesionale, harton kalendarin e zhvillimit të orëve të hapura për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024, në periudhën 1 deri 26 prill 2024 dhe e miraton atë për të gjithë kandidatët.
9. Rezultatet e vlerësimit të mësuesve për orën mësimore të hapur për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit do të dorëzohen në DRAP nga ZVAP-të, brenda datës 6 maj 2024.
10. Rezultatet e vlerësimit të mësuesve për orën mësimore të hapur për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit do të dorëzohen në ASCAP nga DRAP-të në formë elektronike dhe me shkresë zyrtare, brenda datës 13 maj 2024.
11. ASCAP-i organizon seanca informuese me DPAP-në, DRAP-të dhe ZVAP-të për procedurat e organizimit të kualifikimi të mësuesve për të gjitha kategoritë e kualifikimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

